



Lajmet e Fundit:

Pogradec – Vijon operacioni policor i koduar “Basti i fundit”



Lajmet Operacionet

04/03/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Liqeni”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje

Operacioni nga Komisariati i Policisë Nr. 6.

Sekuestrohen 2 armë zjarri, 1 pushkë sportive dhe municion luftarak.

Vihet në pranga poseduesi i tyre, procedohet penalisht djali i tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Nr. 6, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, se një shtetas mbante armë zjarri në banesë, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Liqeni”, në kuadër të të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– N. Xh., 50 vjeç, banues në rrugën “Hamdi Cenoimeri”, në afërsi të liqenit, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Gjithashtu, në kuadër të këtij operacioni u procedua penalisht dhe djali i tij, shtetasi A. Xh., 16 vjeç.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit N. Xh, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri kallashnikov, një armë zjarri pistoletë, një pushkë sportive dhe sasi municioni luftarak.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Share Share Share Share Email

◀ Bulqizë – Vihet në pranga 1 shtetas

Përmet – Arrestohen në flagrancë 2 shtetas ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON



Download on the App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- ◁ Arkiva
- ◁ Akademia e Sigurisë
- ◁ Ministria e Brendshme
- ◁ Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- ◁ Interpol
- ◁ Europol
- ◁ Misioni PAMECA V
- ◁ SCPA
- ◁ Projekti Trivalent